

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zgjidh një grua me fund më të gjatë"/ Komentet e Antonio Tajanit ndezin polemika në Itali, deputetet përgjigjen me minifunde
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/zgjidh-nje-grua-me-fund-me-te-gjate-komentet-e-antonio-tajanit-ndezin-polemika-ne-itali-deputetet-pergjigjen-me-minifunde/1026634/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 07:08:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 07:03:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	614a529969fa5572cf9c56db67a926579c504abd8d95d2c3b204f6cb1c58cc60
TEKSTI	4acf1b32cc6b7a68dcd03f2a21557a90c2ae859d15e21e9ec944457adae2f886
PAMJA	fa5385f5fc7c02346523074ec5d6937ffc8143caee84f1d0297751bb4f3cfbed

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1803fe890e31e2b215e0cb1ce1762241b7f16d1ac6d7512920be615b643bdf4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	491fbc2f0e2919ed311b022f1b5f92632a55c8ad6fb3d3a6ed9398e35c5643c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1803fe890e31e2b215e0cb1ce1762241b7f16d1ac6d7512920be615b643bdf4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Zgjidh një grua me fund më të gjatë"/ Komentet e Antonio Tajanit ndezin polemika në Itali, deputetet përgjigjen me minifunde



Fjalët e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm të Italisë, Antonio Tajani, kanë shkaktuar një valë reagimesh në vend, ku është përfshirë edhe Kisha Katolike.

Gjatë një konference, Tajani u pyet se çfarë do t'i sugjeronte të birit për zgjedhjen e bashkëshortes. Ai u përgjigj se një grua tërheqëse mund të kishte pasur disa lidhje, të ishte divorcuar dhe të kishte prirje për të tradhtuar.

Sipas tij, këshilla do të ishte që i biri të zgjidhte një grua "më pak tërheqëse", por të besueshme, e cila do të ishte nënë e mirë dhe do t'i qëndronte besnike martesës.

"Një që ndoshta vesh funde pak më të gjata se të tjerat", u shpreh Tajani.

Komenti shkaktoi reagime të forta si në radhët e politikës, ashtu edhe në rrjetet sociale. Disa përdorues shpërndanë imazhe të manipuluara të ministrit me minifund, ndërsa deputete të opozitës publikuan fotografi ku shfaqeshin të veshura me funde të shkurtra.

Deputetja e Lëvizjes Pesë Yje, Chiara Apetino, postoi një fotografi me minifund dhe iu drejtua me ironi ministrit.

"Tajani, a nuk jam një grua e besueshme? A nuk jam një nënë e mirë? Në vitin 2026 nuk duhet të dëgjojmë një ministër qeverie që na shpjegon se është më mirë të martohemi me një grua që është më pak mbresëlënëse dhe me një fund më të gjatë. Besueshmëria jonë nuk matet me centimetra pëlhure", shkroi ajo.

Protesta u zhvendos edhe në Senatin italian, ku 11 senatore të opozitës u paraqitën me minifunde në Palazzo Madama. Ato ishin pjesë e Partisë Demokratike, Italia Viva dhe Aleancës së të Gjellbërve dhe të Majtës.

të fundit/



Zgjidh një grua me fund më të gjatë"/ Komentet e Antonio Tajanit nde...



Arabia Saudite në gatishmëri pas sulmeve të Huthëve, Turqia dh...



Përplasja vijon në Shtëpinë e Bardhë, CNN dhe MS NOW...



Ngjarje tronditëse në Brazil/ 31-vjeçarja plagos rëndë njerkun...



BIRN: Zyrtarë të lartë dhe eksponentë të krimit të organizuar...



OVL-UÇK organizon protesta në Kosovë pas aktgjykimit të Speciales



Minçev: Prezenca e nëpunësve në administratë verifikoh...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium



Ish-kryeministri Matteo Renzi i cilësoi deklaratat e Tajanit si të papërshtatshme dhe kërkoi largimin e tij nga qeveria.

"Nuk mund të thuash që një vajzë me një fund pak më të shkurtër nuk është një person serioz. Çfarë është kjo, shekulli i 18-të?", deklaroi Renzi.

Për këtë çështje reagoi edhe Kisha Katolike. Imzot Giuseppe Baturi, kreu i Konferencës së Ipeshkvijve Italianë, theksoi se çdo fjalë dhe vështirësi ndaj një gruaje duhet të shprehë respekt.

"Çdo fjalë dhe çdo vështirësi drejtuar një gruaje duhet të jetë plot respekt dhe admirim", tha Baturi.

Ai nënvizoi gjithashtu se, në këndvështrimin e krishterë, gruaja ka një rol të veçantë dhe se respekti ndaj saj merr rëndësi të posaçme.

Pas polemikave, Antonio Tajani kërkoi falje për fjalët e përdorura. Ministri italian, i cili ndodhet në Nju Jork për Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së, deklaroi se nuk kishte synuar të fyente gratë.

"Kërkoj ndjesë nëse dikush është ofenduar nga ajo që thashë, por kurrë nuk kam pasur për qëllim të ofendoj gratë. Nuk e kam bërë kurrë këtë në jetën time, as në jetën time private dhe as në atë publike", tha Tajani.

Shtuar më 25.09.2026 09:03



Arabia Saudite në gatishmëri pas sulmeve të Huthëve, Turqia dhe...



Përplasja vijon në Shtëpinë e Bardhë, CNN dhe MS NOW përjashtohen nga...



Ngjarje tronditëse në Brazil/ 31-vjeçarja plagos rëndë njerëz dhe ai bie nga ka...



Pezeshkian i dërgon mesazh Trump: Irani gati për marrëveshje, vendimi...



Papa Leo XIV mbërrin të premtën në Francë, rreth 600 mijë besimtarë priten...



Takimi Trump-Xi në Uashington: dhurata simbolike amerikane dhe...



Netanyahu nis fjalimin në OKB mes largimit të diplomatëve: "Frikacakët ...



A i kujtoni këto?/ Netanyahu shfaq në OKB bombat e përdorura për...

